



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: *Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Be-Is” shpk & “Mane” shpk & “Agi Kons” shpk*

Adresa: Farkë Selitë Kodra e Diellit II, Tiranë.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: e zgjedhur në bazë të Nenit 30 të Ligjit Nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu IV, Neni 33 është **“Procedurë e Hapur”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **”Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare ”Dora D’Istria”**, duke realizuar rikonstruksionin e ambienteve të shkollës, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Fondi limit: **81.174.610** (tetëdhjetë e një milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dhjetë) **lekë pa TVSH.**

Burimi i financimit: Të ardhura - vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit Nr.15, datë 21.03.2017 për ”Shpërndarjen e Financimit për Projekte të Reja, Thirrja 1, të Komitetit të rajoneve për zhvillimin e rajoneve ”Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit ”Arsim”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, për vitin 2017

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **17.07.2017 ora 11.00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr 25 datë 27.06.2017.**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatoreve Ekonomikë “Lala” shpk & “Ergi” shpk

NUIS- J76418903B & K02727229P

Vlera e Ofertës pa tvsh **73.146.265** (shtatëdhjetë e tre milion e njëqind e dyzete e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pese) **lekë**

2. Operatori ekonomik ” SENKA/L” shpk

NUIS- J94808405Q

Vlera e Ofertës pa tvsh **73.535.256** (shtatëdhjetë e tre milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) **lekë**

3. Bashkimi i Operatoreve Ekonomikë “Bahas’ shpk & “Avduli” shpk

NUIS J61827083D &J66703306O

Vlera e Ofertës pa tvsh **77.021.815** (shtatëdhjetë e shtatë milion e njëzetë e një mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) **lekë**.

4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Kupa” shpk & “Liqeni VII” & “Ndregjoni” shpk

NUIS K51615512C &K01730502Ë & K31329048II

Vlera e Ofertës pa tvsh **69.996.975** (gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) **lekë**.

5. Operatori Ekonomik “A.N.K” shpk

NUIS J92408001N

Vlera e Ofertës pa tvsh **77.341.890** (shtatëdhjetë e shtatë milion e treqind e dyzetë e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) **lekë**.

6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Be-Is” shpk &” Mane” shpk & “Agi Kons” shpk

NUIS K71412003A & K93810804S &K21622001M

Vlera e Ofertës pa tvsh **67.505.902** (gjashtëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e pesë mijë e nëntëqind e dy) **lekë**.

7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “SIRETA 2F” & “BELADI “shpk

NUIS K51501008J & J 62903254 C

Vlera e Ofertës pa tvsh **76.000.000** (shtatëdhjetë e gjashtë milion) **lekë** .

8. Operatori Ekonomik “Junik” shpk

NUIS J68007522L

Vlera e Ofertës pa tvsh **58.419.603** (pesedhjetë e tete milion e katerqind e nentembdhjetë mijë e gjashtëqind e tre) **lekë**.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm

1. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Lala” shpk & “Ergi” shpk

Perkatesisht per arsyet e meposhteme

Pas hapjes se ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim i Operatoreve Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *AK në dokumentat Standarte te Tenderit ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:*

6.1 Të ketë në stafin e punonjësve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë të paktën për gjashtë muajt e fundit të pakten 21 (njëzetë e një) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- 9 (nëntë) punonjës nga të cilët **2(dy) pllakashtrues, 2(dy) karpentier, 2 (dy) hekurkthyes, 3(tre) bojaxhinj me kategori të I-rë.**

- 9 (nëntë) punonjës , **2(dy) saldator, 2 (dy) hidraulik, 3 (tre) elektromekanik, 2(dy) manovrator me kategori II**

- 1 (një) punonjës elektrikistë me kategori të III

- **1(një) punonjës mekanik me kategori të IV**

- **1(një) punonjës elektrikist me kategori të V**

Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontrata e punës e vlefshme, për manovratorët duhet të paraqesin gjithashtu dhe dëshmite e drejtimit (të vlefshme) nga të cilat një dëshmi të jetë për **automakinistë dhe një tjetër për eskavatoristë, lëshuar nga institucionet përkatëse**

Bashkimi I operatoreve ekonomike te mesiperperm kanë paraqitur në përmbushje të këtij kriteri vetëm një punonjës manovrator (eskavatorist) me kategori të II-të , dy saldator me kategori te dyte , dy karpentier me kategori te pare dhe nje elektrikist me kategori te trete.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi I Operatorëve Ekonomikë “Lala dhe Ergi shpk është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik në pikën 6.1 duke mos paraqitur punonjësit e mëposhtëm të kërkuar nga AK;

2(dy) pllakashtrues, 2 (dy) hekurkthyes, 3(tre) bojaxhinj me kategori të I-rë

Gjithashtu Bashkimi I shoqërive te mesiperme ka paraqitur deshmi per punonjesit e meposhte cituar por qe nuk kane kategorite e kerkuara nga AK

2 (dy) hidraulik, 3 (tre) elektromekanik, 1(nje) manovrator eskavatorist me kategori II

1(një) punonjës mekanik me kategori të IV

1(një) punonjës elektrikist me kategori të V

5.2 Te kete ne staf te punësuar:

a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise)

(Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata (Dip) per eficensen e energjise)

Nuk ka paraqitur dokumenta të cilat të vërtetojnë se ka në staf te punësuar:

a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise)

(Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata (Dip)

Ne permbushje te ketij kriteri Bashkimi I Operatoreve ekonomike kane paraqitur si inxhinier Auditues energjie ZJ. Emanuela Shehaj per te cilen nuk kane paraqitur dokumentacionin e kerkuara nga AK, Bashkia Tirane(Certifikata (Dip))

Pra sa më sipër Bashkimi i Shoqërive “Lala” shpk dhe “Ergi” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelut të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional,6.1 dhe 5.2/a dhe 5.3, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori Ekonomik “Junik” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri 10 ton për secilin kamion)	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
MotoGjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m ³	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamioçinë deri në 2 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Mini eskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri 5 ton per secilin kamion)	2 copë	Pronësi ose me qera
Depozitë uji (5000)	1 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë)	1500 m ²	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Rul	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompe suvatimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Auto vinç me kosh	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinç Kulle	1 copë	Pronësi ose me qera

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) **Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.**

Operatori Ekonomik “Junik” shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm kanë deklaruar në shtojcën nr.9 se dispono mjetet e mëposhtëme:

- Kamionçinë me targa AA172DU me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3.3 Ton

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamionçina **kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë deri në 2 ton** për ekzekutimin e kontratës. Nje nga kamioncinat e deklaruar ne shtojcen nr.9 dhe perkatesisht ajo me targe AA 488 EM do te konsiderohet e rregullt pasi ka kapacitetin mbajtës deri 2 ton por kamioncina me targe AA 172 DU me kapacitet mbajtes mbi 2 Ton nuk konsiderohet e rregullt .

Operatori Ekonomik “Junik” shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm kanë deklaruar në shtojcën nr.9 se dispono mjetet e mëposhtëme:

1. Kamion me targa AA278LR per te cilin ka paraqitur Policen e Sigurimit me nr.serie 2036547 e cila afat skadence ka daten 25.06.2016- **24.06.2017** duke mos permbushur ne kete menyre kriterin e vendosur nga AK me sakte piken 11 germa a ku kerkohet siguracionin e mjetit (te vlefshme)
2. Kamion me targa AA950DV me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **28 Ton**
3. Kamion me targa TR2639S me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **23Ton**
4. Kamion me targa LA9492A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **24 Ton**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona vetëshkarkues **kapaciteti mbajtës duhet të jetë deri në 5 ton secili si dhe dy kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës për secilin duhet të jetë deri në 10 ton** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomikë nuk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri asnje kamion vetëshkarkues pasi Kamionet e e deklaruar nga operatori ekonomik kanë kapacitetin mbajtës mbi **10 ton** .

- Operatori ekonomik “Junik” sha ka deklaruar në shtojcën 9 eskavator me goma copë 1 në pronësi i paisur me faturë doganore me nr. 620. Për eskavatorin me goma shoqëria nuk ka paraqitur lejë qarkullim, çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit, C’ka bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kualifikim”, kapaciteti Teknik pika 11, gërma (a) ku citohet:

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e

tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi

Pra sa më sipër cituar eskavatori me goma nuk ka lejën e qarkullimit, Çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti. Gjithashtu theksojmë se AK ka kërkuar për realizimin e kontratës me sukses paraqitjen e nje **eskavatori me goma. Operatori ekonomik nuk e ka përmbushur kushtin e mësipërm.**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 9 , me pikën 11 është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Kupa” shpk & “Liqeni VII” & “Ndregjoni” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes se ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim i Operatorëve Ekonomikë, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *AK në dokumentat Standarte te Tenderit ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:*

6.1 Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë të paktën për gjashtë muajt e fundit të pakten 21 (njëzetë e një) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- 9 (nëntë) punonjës nga të cilët **2(dy) pllakashtrues**, 2(dy) karpentier, **2 (dy) hekurkthyes**, **3(tre) bojaxhinj me kategori të I-rë.**
- 9 (nëntë) punonjës , **2(dy) saldator**, 2 (dy) hidraulik, **3 (tre) elektromekanik**, **2(dy) manovrator me kategori II**
- 1 (një) punonjës elektrikistë me kategori të III
- **1(një) punonjës mekanik me kategori të IV**
- 1(një) punonjës elektricist me kategori të V

Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontrata e punës e vlefshme, për manovratorët duhet të paraqesin gjithashtu dhe deshmite e drejtimit (të vlefshme) nga të cilat një dëshmi të jetë për **automakinistë** dhe një tjetër për **eskavatoristë, lëshuar nga institucionet përkatëse**)

Bashkimi I operatoreve ekonomike te mesiperperm kanë paraqitur në përmbushje të këtij kriteri vetëm një punonjës manovrator (eskavatorist) me kategori të II-të , 1 punonjës pllakashtrues te paisur me deshmi kualifikimi pasi Operatori ekonomik Kupa ka paraqitur nje punonjes pllakashtrues por nuk ka paraqitur deshmi kualifikimi, nje punonjes bojaxhi te cilin e ka paraqitur shoqëria LIqeni VII, nje punonjes saldator shoqëria KUPA shpk pasi saldatori I paraqitur nga Liqeni VII Z.L.K ka deshmime e kualifikimit te skaduar me dtae 3.05.2017., dy punonjes elektromekanik duke mos permbushur kushtin edhe ketu pasi AK ka kerkuar tre punonjes elektromekanike me kategori te dyte, dy saldator me kategori te dyte , dy karpentier me kategori te pare dhe nje elektricist me kategori te trete, dy karpentier, dy hidraulik, nje punonjes elektricist me kategori te III-te **por nuk kane paraqitur punonjes mekanik me kategori te IV si dhe punonjes elektricist me kategori te peste.**

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi I Operatoreve Ekonomikë “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik në pikën 6.1 duke mos paraqitur punonjësit e mëposhtëm të kërkuar nga AK;

1(një) pllakashtrues, 2 (dy) hekurkthyes, 2(dy) bojaxhinj me kategori të I-rë

1 (një) saldator, 1 (nje) elektromekanik, 1(nje) manovrator automakinist me kategori II

1(një) punonjës mekanik me kategori të IV

1(një) punonjës elektricist me kategori të V

5.2 Te kete ne staf te punësuar:

a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise)

(Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata (Dip) per eficensen e energjise)

Nuk ka paraqitur dokumenta të cilat të vërtetojnë se ka në staf te punësuar:

a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise)

(Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata (Dip)

Ne permbushje te ketij kriteri Bashkimi I Operatoreve ekonomike kane paraqitur si inxhinier Auditues energjie Z. Neritan Çipllaka per te cilen nuk kane paraqitur dokumentacionin e kerkuara nga AK, Bashkia Tirane(**Certifikata (Dip)**)

Pra sa më sipër Bashkimi i Shoqërive **Kupa shpk & Liqeni VII & Ndrejoni shpk** nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, 6.1 dhe 5.2/a dhe 5.3, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të

Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Bashkimi Operatorëve Ekonomik “Bahas” shpk & “Avduli” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes se ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim Operatorësh ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

I. Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në pikën 6.1 si më poshtë cituar:

- *AK në dokumentat Standarte te Tenderit ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:*

6.1 Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë të paktën për gjashtë muajt e fundit të pakten 21 (njëzetë e një) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- *9 (nëntë) punonjës nga të cilët 2(dy) pllakashtrues, 2(dy) karpentier, 2 (dy) hekurkthyes, 3(tre) bojaxhinj me kategori të I-rë.*
- *9 (nëntë) punonjës , 2(dy) saldator, 2 (dy) hidraulik, 3 (tre) elektromekanik, 2(dy) manovrator me kategori II*
- *1 (një) punonjës elektrikistë me kategori të III*
- *1(një) punonjës mekanik me kategori të IV*
- *1(një) punonjës elektrikist me kategori të V*

Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontrata e punës e vlefshme, për manovratorët duhet të paraqesin gjithashtu dhe dëshmite e drejtimit (të vlefshme) nga të cilat një dëshmi të jetë për automakinistë dhe një tjetër për eskavatoristë, lëshuar nga institucionet përkatëse)

Nga verifikimi në sistem i dokumentave të ngarkuar për kualifikim në procedurën e mësipërme nga Bashkimi i Operatorëve rezulton se:

1.AK ka kërkuar një punonjës mekanikë të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori IV.

Bashkimi I operatorëve kanë paraqitur vetëm një punonjës mekanik me kategori të tretë por nuk ka paraqitur punonjës me kategori te katert.

2.AK ka kërkuar një punonjës Elektracist të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori te V-të.

Bashkimi I operatorëve kanë paraqitur punonjës elektrikist me kategori të katërt

*Bashkimi i Operatorëve ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që AK i vlerëson të nevojshme.....***

*b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe **personelin e nevojshëm** për të zbatuar kontratën.*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të kualifikimit pika 6.1 është I paplotë , për rrjedhojë i pavlefshëm

Në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 11 citohet:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri 10 ton për secilin kamion)	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
MotoGjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0,25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamioçinë deri në 2 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Mini eskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri 5 ton per secilin kamion)	2 cope	Pronësi ose me qera
Depozitë uji (5000)	1 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë)	1500 m2	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm kanë deklaruar në shtojcën nr.9 se disponojë mjetin kamioçinë me targa AA143 JE por nga verifikimi në dokumentat e paraqitura nga ky operator ne sistemin elektronik të app-së rezulton se Bashkimi i operatorëve ekonomik të mësipërm nuk kanë paraqitur dokumentacion për mjetin kamioçinë me targa AA 143 Je.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamionçina **kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë deri në 2 ton** për ekzekutimin e kontratës. Bashkimi I Operatorëve Ekonomikë ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri vetëm një kamionçinë dhe përkatësisht kamionçina me targë AA 627MS .

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomikë lidhur me shtojcën 9 , me pikën 11 është i paplotë , për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

5. Operatori Ekonomik “SENKA/L” shpk.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes se ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 11 citohet:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri 10 ton për secilin kamion)	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
MotoGjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë deri në 2 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Mini eskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qera

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri 5 ton per secilin kamion)	2 cope	Pronësi ose me qera
Depozitë uji (5000)	1 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë)	1500 m2	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera

e) **Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.**

Operatori ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm kanë deklaruar në shtojcën nr.9 se disponojë mjetet e mëposhtme:

1. *Autobetoniere DR9867E per te cilin nuk ka paraqitur ne sistemin elektronik te app-se foto sic eshte kerkuar nga AK ne piken 11 germa e*

2. *Autobetoniere AA721NN per te cilin nuk ka paraqitur ne sistemin elektronik te app-se foto sic eshte kerkuar nga AK ne piken 11 germa e*

3. *Kamion me targa AA209DT nga verifikimi që anëtarët e KVO-së bënë në sistemin elektronik të app-së më saktë në lejën e qarkullimit rezulton se mjeti i deklaruar si kamion vetshkarkues 10 ton është tërheqës për këtë tërheqës theksojmë se nuk është paraqitur rimorkio*

4. *Kamion me targa LU 2253C nga verifikimi që anëtarët e KVO-së bënë në sistemin elektronik të app-së më saktë në lejën e qarkullimit rezulton se mjeti i deklaruar si kamion vetshkarkues 10 ton është tërheqës për këtë tërheqës theksojmë se nuk është paraqitur rimorkio*

5. *Autobot Uji me targa AA684DN per te cilin nuk ka paraqitur ne sistemin elektronik te app-se foto sic eshte kerkuar nga AK ne piken 11 germa e*

6. *Autobot vinc me kosh me targa AA273LS per te cilin nuk ka paraqitur ne sistemin elektronik te app-se foto sic eshte kerkuar nga AK ne piken 11 germa e*

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona kapaciteti mbajtës për secilën kamion deri në 10 ton për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomikë ka paraqitur me dokumentacion të rregullt në përmbushje të këtij kriteri vetëm një kamion dhe përkatësisht kamionin me targë AA864CJ .

Gjithashtu për mjetet e deklaruara më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe foto ku të jetë e dukshme targa e mjetit. Për mjetet e mësipërme operatori ekonomik nuk ka paraqitur foto ashtu sic edhe kërkohet në dokumentat standarte të tenderit /kriteret e vecanta të kualifikimit pika 11 germa e.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomikë lidhur me shtojcën 9 , me pikën 11 është i paplotë , për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqëritë **“Be-Is” shpk & “Mane” shpk & “Agi Kons” shpk** me adresë: Adresa: Farkë Selitë Kodra e Diellit II, Tiranë., se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa t.v.sh **67.505.902** (gjashtëdhjetë e shtatëmilion e pesëqind e pesë mijë e nëntëqind e dy) **lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nese eshte kerkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit, është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme pa t.v.sh **76.000.000** (shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.07.2017.

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesmarrëse në këtë procedure prokurimi në mbështetje të nenit 63 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nuk është paraqitur asnjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktor në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

